REPUBLIKA E SHQIPËRISË

`BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Bilisht me,_____/_____/2026

PROJEKT-VENDIM

NR. 12, DATË 22/01/2026

''Për rishqyrtimin e disa pikave ne Vendimin nr. 97, datë 26.12.2025 të Këshillit Bashkiak Devoll "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë dhe të punonjësve administrativë të Bashkisë Devoll për vitin 2026",

në zbatim të shkresës së Prefektit të Qarkut Korçë me nr 17/1 date 13.01.2026 dhe prot ne Institucionin tone me 3/1 date 13.01.2026.

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore" Ligiit Nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;"Ligjit Nr.152/2013, "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar ,Ligji Nr. 7961, datë12.07.1995 "Kodi i Punës I Republikës së Shqipërisë" I ndryshuar, Vendimit Nr.419 datë 26.06.2024 " Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pages bruto mujore të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", Vendimi Nr. 503 datë 01.08.2024 "Për disa ndyshime në Vendimin Nr.328, date 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave " Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emërur, të nëpunësve civilë e të punonjësve administativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" Vendimi Nr. 421 datë 26.06.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 325 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministarve për miratimin e struktures së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zvëndësministrave të funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënrefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administrates publike" të ndryshuar, Vendimit Nr.425 datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", Ligjit Nr. 35/2023 " Për kompetencat dhe caktimin e pagave, trajtimeve te tjera financiare dhe perfitimeve te te punesuarve ne institucionet e administrates publike, si dhe te pages baze minimale ne shkalle vendi",i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 776, datë 19.12.2025 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

PROPOZON:

1.Në Vendimin nr. 97, datë 26.12.2025 të Këshillit Bashkiak Devoll "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë dhe të punonjësve administrativë të Bashkisë Devoll për vitin 2026", në zbatim të shkresës së Prefektit të Qarkut Korçë nr. 17/1 prot., datë 13.01.2026 , bëhen ndryshimet dhe saktësimet si më poshtë:

1.1 Për pikën (a) – Policia Bashkiake

Rishikohet trajtimi financiar për disa pozicione të Policisë Bashkiake, me qëllim pershtatjen në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, në përputhje me ligjit 35/2023 Për kompetencat dhe caktimin e

pagave, trajtimeve te tjera financiare dhe perfitimeve te te punesuarve ne instituconet e administrates publike, si dhe te pages baze minimale ne shkalle vendi".(I ndryshuar)si dhe vkm-se 328/ 2023''Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emërur, të nëpunësve civilë e të punonjësve administativë të njësive të vetëqeverisjes vendore(I ndryshuar)

1.2 Për pikën (b) – Pozicione drejtuese/mbikëqyrëse në arsimin parashkollor

Për pozicionet drejtuese dhe mbikëqyrëse të arsimit parashkollor (si: "Drejtor", "Përgjegjës sektori", "Inspektor kopshti'', *u jemi referuar VKM Nr. 503 datë 01.08.2024 "Për disa ndyshime në Vendimin Nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministarve" Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emërur, të nëpunësve civilë e të punonjësve administativë të njësive të vetëqeverisjes vendore,lidhjes nr 6 te VKM-se nr 503 date 31.05.2023*

1.3 Për pikën (c) – Edukatore

-Te Plotësohet dhe saktësohet klasifikimi (klasa/kategoria) dhe niveli i pagës për pozicionin "Edukator(e)" në institucionet parashkollore, në përputhje me VKM nr. 425, datë 26.06.2024 dhe konkretisht Lidhja nr 3 sipas aneksit nr 3

1.4 Për pikën (d) – Çerdhja

Për pozicionet në Çerdhen e Fëmijëve (përgjegjës çerdhe, punonjës çerdhe dhe ndihmës mjek/infermier), përcaktohet dispozita ligjore përkatëse, klasa/kategoria dhe niveli i trajtimit financiar, në zbatim te *VKM Nr. 503 datë 01.08.2024 "Për disa ndyshime në Vendimin Nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministarve" Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emërur, të nëpunësve civilë e të punonjësve administativë të njësive të vetëqeverisjes vendore.*

-Per punonjesit administrative te Bashkise dhe konkretisht punonjese cerdhe me arsim te mesem ,njesive te veteqeverisjes vendore jane referuar per analogji pikes 11 te Vkm –se 328 date 31.02.2023 të Këshillit të Ministarve" Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emërur, të nëpunësve civilë e të punonjësve administativë të njësive të vetëqeverisjes vendore **dhe** Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 776datë 19.12.2025 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

1.5 Për pikën (e) – Sektori i organizimit të aktiviteteve kulturore

Për pozicionet në sektorin e organizimit të aktiviteteve kulturore (përgjegjës sektori, instrumentist, këngëtar, koreograf), përcaktohet klasa/kategoria dhe baza ligjore e trajtimit financiar në përputhje me ***ligjin 35/2023*** **Për kompetencat dhe caktimin e pagave, trajtimeve te tjera financiare dhe perfitimeve te te punesuarve ne instituconet e administrates publike, si dhe te pages baze minimale ne shkalle vendi".(I ndryshuar)si dhe** *vkm-se 328/ 2023''Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emërur, të nëpunësve civilë e të punonjësve administativë të njësive të vetëqeverisjes vendore*(I ndryshuar) sipas anerksit nr 5

1.6 Për pikën (f) – Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve

Korrigjohet grupi i diplomës dhe trajtimi përkatës financiar për pozicionin "Instruktor" në Qendrën Kulturore të Fëmijëve, në përputhje me VKM nr. 425 date 26.06.2024 sipas aneksit nr 6 .

1.7 Për pikën (g) – Gjendja civile (Nj.A. Hoçisht)

Në lidhje me vërejtjen e Prefektit për pozicionin "Punonjës i Gjendjes Civile në Njësinë Administrative Hoçisht", theksojme se bazohemi ne vkm nr 326 date 31.05.2023 ,Kreu II/1 Klasa X.

Ne vijim sqarojmë se niveli i pagës i përcaktuar për këtë pozicion lidhet me klasifikimin e funksionit dhe kriteret e vendosura nga aktet nënligjore në fuqi, ku kriteri arsimor për ushtrimin e këtij pozicioni është "arsim i mesëm". Për rrjedhojë, trajtimi financiar i miratuar nga Këshilli Bashkiak për këtë punonjës është përcaktuar në përputhje me kriterin arsimor "shkollë e mesme", si dhe me klasifikimin përkatës mer lart duke mos pasur bazë ligjore që ky pozicion të trajtohet domosdoshmërisht me nivel page të lidhur me arsim të lartë. Në këtë kuadër, pas verifikimit të dokumentacionit të personelit, konstatohet se trajtimi financiar është i rregullt dhe nuk kërkon ndryshim.

2.Te miratohen anekset e rishikuara për pozicionet dhe nivelin e pagave që ndryshohen në zbatim të shkresës së Prefektit të Qarkut Korçë nr17/1 prot., datë 13.01.2026, dhe ato te shtuara ne funsksion te ndryshimit te pages minimale si më poshtë:

3.Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 776, datë 19.12.2025 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", paga bazë minimale mujore për pozicionet e punës që trajtohen me pagë minimale rishikohet dhe përcaktohet në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, me efekte financiare nga data 01.01.2026.

1.Aneksi nr. 1 – Reflektim për pikën (a) "Policia Bashkiake";

VITI 2026								
PERSHKRIMI		NR	Emer	Mbiemer	KlaSa	NIVELI	Paga e Pozicionit	Shtesa per Vjet
3	PUNONJES I POLICISE BASHKIAKE	12			Pika 10		52000	1%
					Pika 10		52000	1%
					Pika 10		52000	1%
					Pika 10		52000	1%
					Pika 10		52000	1%
					Pika 10		52000	1%
					Pika 10		52000	1%
					Pika 10		52000	1%
					Pika 10		52000	1%

					Pika 10		52000	1%
					Pika 10		52000	1%
					Pika 10		52000	1%

2.Aneksi nr. 2 – Reflektim për pikën (b) "Pozicione drejtuese/mbikëqyrëse në arsimin parashkollor";

VITI 2026							
PERSHKRIMI	NR	Emer	Mbiemer	KlaSa	NIVELI	Paga e Pozicionit	Shtesa per
DREJTOR	1			II-2	85000-141000	125000	0.6-1 %
PERGJEGJES SEKTORI 1				III-2	70000-105000	70000	0.6-1 %
INSPEKTORE KOPSHTI		2		IV-3	42000-70000	55000	06-1%

3.Aneksi nr. 3 – Reflektim për pikën (c) "Edukator(e)"; Lidhja nr 3 VKM-se nr 425 date 26.06.2024

1	PUNONJES TE ARSIMIT PARASHKOLLOR EDUKATORE	55			Lidhja nr 3		58000	0.6-1 %
2	DREJTOR KOPSHTI PA USHQIM	5			Lidhja nr 3		75000	0.6-1 %

4.Aneksi nr. 4 – Reflektim për pikën (d) "Çerdhja – Përgjegjës/Punonjës/Ndihmës mjek (infermier)";

VITI 2026							
PERSHKRIMI	NR	Emer	Mbiemer	KlaSa	NIVELI	Paga e Pozicionit	Shtesa per Vj
PERGJEGJES CERDHE	1			III-2	70000-105000	70000	0.6- 1 %
PUNONJES CERDHE	5			IV-4	40000-60000	55000	0.6- 1 %
				IV-4	40000-60000	55000	0.6- 1 %
				IV-4	40000-60000	55000	0.6- 1 %
				IV-4	40000-60000	55000	0.6- 1 %
PUNONJES CERDHE	3			Pika 11	40.000-47000	50000	1%

				Pika 11	40.000-47000	50000	1%
				Pika 11	40.000-47000	50000	1%
Specialist Ndihmes mjek(infermier)	1			IV-4	40000-60000	55000	0.6- 1 %

5.Aneksi nr. 5 – Reflektim për pikën (e) "Organizimi i aktiviteteve kulturore";

SEKTORI I ORGANIZIMIT TE AKTIVITETEVE KULTURORE							
PERGJEGJES SEKTORI	1			III-2	70.000-105000	70000	0.6-1%
SPECIALIST KULTURE	3			IV-4	40000-60000	50000	0.6-1%
				IV-4	40000-60000	50000	0.6-1%
				IV-4	40000-60000	50000	0.6-1%
INSTRUMENTISTE,KENGETARE	7		6 ore	Pika 10	40.000-47000	50000	1%
			6 ore	Pika 10	40.000-47000	50000	1%
			6	Pika 10	40.000-47000	50000	1%
			6	Pika 10	40.000-47000	50000	1%
			6	Pika 10	40.000-47000	50000	1%
			6	Pika 10	40.000-47000	50000	1%
			6	Pika 10	40.000-47000	50000	1%
KOREOGRAF	1		6	Pika 10	40.000-47000	50000	1%
	12						

Shenim:Në këtë Aneks, ndryshohet vetëm "Paga e pozicionit" për punonjësit, ku paga e pozicionit ka qenë 47.000 lekë, duke u bërë 50.000 lekë.Paga e pozicionit per piken 10, eshte 50.000 per 8 ore pune.

Diapazonet dhe klasifikimi i pozicioneve ("Niveli i pagës") mbeten per analogji te VKM nr. 328, datë 31.05.2023 (i ndryshuar).

6.Aneksi nr. 6 – Reflektim për pikën (f) "Instruktor – Qendra Kulturore e Fëmijëve".**Sipas VKM Nr. 425, datë 26.6.2024, Lidhja Nr. 3, Niveli I pagave për punonjësit mësimorë në Bashkinë Devoll**

Nr.	Emërtimi	Paga e pozicionit	Grupi I Diplomës
1.	Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	60, 000	1

7.Shtohet aneksi per ndryshimin e pages minimale ne zbatim te vendimit nr 776 date 19.12.2025 per funksionet e meposhtme

			Ishte	Behet
Nr	**Emertesa e pozicionit**	**Nr I punonjesve**	**Paga sipas vendimit nr 328 date 31.05.2023**	**Paga sipas vendimi nr 776, date19.12.2025**
1	Magazinier	1	47000	50000
2	Punonjes Ndihmes Qendra Sociale	3	47000	50000
3	Kuzhinier Qendra Sociale	1	47000	50000
4	Punonjes Cerdheje	3	47000	50000
5	Kuzhinier Cerdheja e Femijeve	1	47000	50000
6	Roje pylli	6	47000	50000

Anekset e mësipërme janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3.Pjesa tjetër e Vendimit nr. 97, datë 26.12.2025 mbetet e pandryshuar.

4 Për zbatimin e këtyre vendimeve ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit.

5.Ky vendim hyn në fuqi pas shpalljes, sipas Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 55, pika 6.

Sp ne Drejtorine e Menaxhimit te Burimeve Njerëzore
I.Spahi
Pergjegjes i zyrës juridike
E.Avdo
Sekretar i Pergjithshem
A.Rushitaj

KRYETARI BASHKISË

EDUARD DURO

Adresa: Bashkia Devoll,Lagjia nr 1 Rr "24 Tetori" nr 9 Bilisht Tel.Fax: +355 811 2 2288 e-mail bashkiadevoll@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Bilisht me, 21 / 01 **/2026**

Nr 280 **Date** 21.01.2026

RELACION

Per project vendimin ''Per rishqyrtimin e disa pikave në Vendimin nr. 97, datë 26.12.2025 të Këshillit Bashkiak Devoll "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë dhe të punonjësve administrativë të Bashkisë Devoll për vitin 2026",

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore" Ligiit Nr. 68/2017, datë 27.04.2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; " Ligjit Nr.152/2013, "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar ,Ligji Nr. 7961, datë12.07.1995 "Kodi i Punës I Republikës së Shqipërisë" I ndryshuar, Vendimit Nr.419 datë 26.06.2024 " Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pages bruto mujore të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", Vendimi Nr. 503 datë 01.08.2024 "Për disa ndyshime në Vendimin Nr.328, date 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave " Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emërur, të nëpunësve civilë e të punonjësve administativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" Vendimi Nr. 421 datë 26.06.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 325 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministarve për miratimin e struktures së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zvëndësministrave të funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënrefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administrates publike" të ndryshuar, Vendimit Nr.425 datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", Ligjit Nr. 35/2023 " Për kompetencat dhe caktimin e pagave, trajtimeve te tjera financiare dhe perfitimeve te te punesuarve ne institucionet e administrates publike, si dhe te pages baze minimale ne shkalle vendi",i ndryshuar.

1.Hyrje dhe pershkrim I pergjithshem

Te nderuar keshilltarë!

Në vijim të miratimit të Vendimit nr. 97, datë 26.12.2025 të Këshillit Bashkiak Devoll "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë dhe të punonjësve administrativë të Bashkisë Devoll për vitin 2026", Prefekti i Qarkut Korçë, në kuadër të ushtrimit të funksionit të kontrollit të ligjshmërisë së akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore, ka kryer verifikimin e bazueshmërisë ligjore të këtij vendimi.

Nga verifikimi, Prefekti ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të Vendimit nr. 97 në parim, por ka kërkuar reflektimin e disa korrigjimeve dhe saktësimeve, të cilat janë evidentuar në shkresë me pikat (a–g).

Në funksion të bashkëpunimit institucional dhe për të garantuar përputhjen e plotë të aktit me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, paraqitet për miratim ky projekt–vendim, i cili synon të reflektojë saktësimet e kërkuara nga Prefekti, duke ruajtur strukturën dhe trajtimin financiar të përgjithshëm të miratuar për vitin 2026.

I. Qëllimi i projekt–vendimit

Qëllimi i projekt–vendimit është:

-të reflektojë vërejtjet e Prefektit lidhur me disa pozicione specifike;

-të përmirësojë saktësinë e klasifikimit (klasa/kategoria, grup diplome) dhe trajtimin financiar;

-të shmangë paqartësi në zbatim;

-të garantojë kontroll më të lehtë ligjor dhe financiar mbi fondin e pagave;

-të plotësojë detyrimet ligjore për organizimin e administratës vendore dhe pagave sipas VKM-ve në fuqi.

II. Argumentimi sipas pikave të Prefektit (a–g)

Pika (a) – Policia Bashkiake

Në bazë të vërejtjes së Prefektit lidhur me trajtimin financiar të disa pozicioneve të Policisë Bashkiake, në projekt–vendim sqarojme se niveli I pages së pozicioneve përkatëse.bazohet ne ligjin 35/2023 ''Për kompetencat dhe caktimin e pagave, trajtimeve te tjera financiare dhe perfitimeve te te punesuarve ne instituconet e administrates publike, si dhe te pages baze minimale ne shkalle vendi si dhe vkm-se 328/ 2023''Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emërur, të nëpunësve civilë e të punonjësve administativë të njësive të vetëqeverisjes vendore(I ndryshuar)

*Detyra per te cilat ekziston bashkia si(punonjes te Agjensise se Sherbimeve Publike,manovratore,instumentiste , **dhe punonjesit e policise bashkiake** ,kufijte e pagave baze te punonjesve jane referuar shkronjes b) ku citohet se Keshilli bashkiak ben njësimin në pagë në përputhje me klasifikimin e funksioneve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave për çdo funksion të ri që vendosin të krijojnë dhe pikes d) ku citohet se :pagat e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë së tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të rasteve, kur me ligj të veçantë, është parashikuar ndryshe* **te nenit 9 te ligjit 35/2023 Për kompetencat dhe caktimin e pagave, trajtimeve te tjera financiare dhe perfitimeve te te punesuarve ne instituconet e administrates publike, si dhe te pages baze minimale ne shkalle vendi".(I ndryshuar)**

Pikes 9 ku citohet se *Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, kur shikohet e nevojshme të krijojnë funksione të reja, të cilat nuk janë përcaktuar në lidhjet që i bashkëlidhen këtij vendimi,(vkm-se nr 328/2023) bëjnë njësimin e tyre, për efekt page, me klasifikimin e miratuar në lidhjet përkatëse të pagave* ***dhe pikes 10*** *ku citohet se Keshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore miratojnë pagat e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë, me përjashtim të rasteve kur, me ligj, është parashikuar ndryshe, duke respektuar hierarkinë e pagave të nëpunësve apo punonjësve të*

bashkisë përkatëse te vkm-se 328/ 2023Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emërur, të nëpunësve civilë e të punonjësve administativë të njësive të vetëqeverisjes vendore(I ndryshuar)

Pika (b) – Pozicione administrative/monitoruese në arsimin parashkollor (argument i zgjeruar)

Prefekti ka evidentuar nevojën për saktësim të bazës ligjore dhe trajtimit financiar për pozicionet:

"Drejtor","Përgjegjës sektori","Inspektor kopshti"

Në lidhje me këtë vërejtje, Bashkia Devoll sqaron dhe argumenton si më poshtë:

1) Këto pozicione janë funksione të Bashkisë dhe jo pozicione mësimore

Pozicionet e mësipërme janë pjesë e organikës së Bashkisë Devoll dhe nuk kryejnë funksione mësimore apo pedagogjike. Ato janë krijuar për të garantuar administrimin e shërbimeve publike vendore në fushën e arsimit parashkollor.

Në thelb, këto pozicione ushtrojnë:

-funksione administrative dhe monitoruese,

-funksione koordinuese dhe planifikuese,

-funksione raportuese dhe menaxheriale.

Funksioni i këtyre pozicioneve lidhet me menaxhimin e institucioneve parashkollore (kopshte) në nivel vendor, duke përfshirë:

- planifikim dhe raportim institucional,

-koordinim me institucionet vartëse dhe institucionet partnere,

-menaxhim logjistik dhe standarde infrastrukturore të objekteve,

-marrëdhënie pune me personelin (organizim pune, disiplinë administrative, orare, mungesa),

- statistika dhe tregues performance në nivel institucioni,

- përgatitje e planit buxhetor, planifikim shpenzimesh dhe nevoja për investime,

-monitorim i zbatimit të standardeve administrative dhe higjieno–sanitare,

- ndjekje e inventarëve, materialeve, shërbimeve dhe mirëmbajtjes.

<u>Pra këto funksione janë tipike të administrimit vendor, jo të arsimit si sistem pedagogjik.</u>

3) Nuk ushtrojnë kompetenca mësimore/pedagogjike

Pozicionet nuk merren me:

-mësimdhënie,

-program mësimor/kurrikula,

-vlerësim pedagogjik të edukatoreve,

-certifikim profesional,

-inspektim arsimor në kuptimin e sistemit parauniversitar.

Në këtë kuptim, ato nuk janë pjesë e stafit mësimor, por pozicione administrative të bashkisë që sigurojnë funksionimin e shërbimit parashkollor si shërbim publik.

4) Baza ligjore e pagës

Për efekt page dhe klasifikimi, Bashkia parashikon rregullimin dhe saktësimin e trajtimit financiar duke u mbështetur në *VKM Nr. 503 datë 01.08.2024 "Për disa ndyshime në Vendimin Nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministarve" Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emërur, të nëpunësve civilë e të punonjësve administativë të njësive të vetëqeverisjes vendore,lidhjes nr 6 te VKM-se nr 503 date 31.05.2023*

, e cila rregullon klasifikimin e pagave për administratën vendore.

Kjo zgjedhje lidhet me faktin se pozicionet në fjalë janë:

-pozicione të organikës së Bashkisë,

-me funksione administrative,

-me përgjegjësi koordinuese dhe monitoruese.

Pika (c) – Edukatore

Prefekti ka kërkuar saktësim të klasifikimit dhe nivelit të pagës për pozicionin "Edukatore". Ky pozicion trajtohet sipas kuadrit ligjor përkatës, komkretisht ligjit nr 425 date 26.06.2024"Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar ,lidhja nr 3 .

Pika (d) – Çerdhja (argument i zgjeruar si funksion bashkie)

Në lidhje me pozicionet:

-Përgjegjës çerdhe

-Punonjës çerdhe

-Ndihmës mjek / Infermier

Prefekti ka kërkuar saktësim të dispozitës ligjore dhe klasifikimit.

Bashkia sqaron se pozicionet në çerdhe janë pjesë e një shërbimi publik vendor me natyrë sociale–komunitare dhe administrative, ku dominon menaxhimi institucional, standardet e sigurisë dhe organizimi i shërbimit.

Funksionet kryesore janë funksione bashkie, sepse lidhen me:

Planifikim dhe raportim për funksionimin e institucionit,koordinim ndërinstitucional me qendrat shëndetësore, institucionet e mbrojtjes së fëmijëve dhe strukturat vendore, menaxhim logjistik dhe standarde infrastrukture (kushte higjieno-sanitare, siguri fizike, pajisje, inventar), marrëdhënie pune me personelin dhe organizim i shërbimit ditor,tregues statistikorë (frekuentim, mungesa, raste shëndetësore),përgatitje e planit buxhetor për ushqim, materiale, shërbime, mirëmbajtje, etj.

Pra këto nuk janë funksione arsimore në kuptimin e sistemit parauniversitar, por funksione organizimi shërbimi publik vendor.

Në këtë kuadër, Bashkia parashikon saktësim të plotë të klasifikimit, pagës dhe bazës ligjore, duke e lidhur me *VKM Nr. 503 datë 01.08.2024 "Për disa ndyshime në Vendimin Nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministarve" Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emërur, të nëpunësve civilë e të punonjësve administativë të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe pikes 11 te Vkm –se 328 date 31.02.2023 të Këshillit të Ministarve" Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emërur, të nëpunësve civilë e të punonjësve administativë të njësive të vetëqeverisjes vendore* ***konkretisht VKM nr. 776, datë 19.12.2025 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", është e domosdoshme që për pozicionet e punës të cilat trajtohen me pagë minimale, paga bazë mujore të përshtatet dhe të reflektojë nivelin e ri të pagës minimale prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.***

Pika (e) – Organizimi i aktiviteteve kulturore

Prefekti ka kërkuar saktësim të klasës dhe dispozitës ligjore për disa pozicione të sektorit të organizimit të aktiviteteve (përgjegjës sektori, instrumentist, këngëtar, koreograf). Projekt–vendimi parashikon plotësimin e klasifikimit dhe përcaktimin e bazës ligjore të trajtimit financiar për këto pozicione, në përputhje me ligjin nr 35/2023 ''Për kompetencat dhe caktimin e pagave, trajtimeve te tjera financiare dhe perfitimeve te te punesuarve ne instituconet e administrates publike, si dhe te pages baze minimale ne shkalle vendi".(I ndryshuar) si dhe vkm-se 328/ 2023Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emërur, të nëpunësve civilë e të punonjësve administativë të njësive të vetëqeverisjes vendore(I ndryshuar)

Per punonjesit mbeshtetes e thene ndryshe punonjes qe kerkojne aftesi profesionale detyra per te cilat ekziston bashkia si(punonjes te Agjensise se Sherbimeve Publike,manovratore,instumentiste , dhe punonjesit e policise bashkiake ,kufijte e pagave baze te punonjesve jane referuar shkronjes b) ku citohet se Keshilli bashkiak ben njësimin në pagë në përputhje me klasifikimin e funksioneve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave për çdo funksion të ri që vendosin të krijojnë dhe pikes d) ku citohet se :pagat e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë së tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të rasteve, kur me ligj të veçantë, është parashikuar ndryshe ***te nenit 9 te ligjit 35/2023*** **Për kompetencat dhe caktimin e pagave, trajtimeve te tjera financiare dhe perfitimeve te te punesuarve ne instituconet e administrates publike, si dhe te pages baze minimale ne shkalle vendi".(I ndryshuar)**

Pikes 9 ku citohet se *Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, kur shikohet e nevojshme të krijojnë funksione të reja, të cilat nuk janë përcaktuar në lidhjet që i bashkëlidhen këtij vendimi,(vkm-se nr 328/2023) bëjnë njësimin e tyre, për efekt page, me klasifikimin e miratuar në lidhjet përkatëse të pagave* ***dhe pikes 10*** *ku citohet se Keshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore miratojnë pagat e*

punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë, me përjashtim të rasteve kur, me ligj, është parashikuar ndryshe, duke respektuar hierarkinë e pagave të nëpunësve apo punonjësve të bashkisë përkatëse te vkm-se 328/ 2023Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emërur, të nëpunësve civilë e të punonjësve administativë të njësive të vetëqeverisjes vendore(I ndryshuar)

Pika (f) – Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve

Prefekti ka evidentuar mospërputhje në grupin e diplomës. Projekt–vendimi parashikon korrigjimin e grupit të diplomës dhe trajtimit përkatës financiar në përputhje me VKM nr. 452/2024.

Pika (g) – Gjendja civile (pa ndryshim)

Në lidhje me vërejtjen për pozicionin "Punonjës i Gjendjes Civile në Nj.A. Hoçisht", Bashkia ka kryer verifikimin e dokumentacionit të personelit dhe kritereve të pozicionit. Nga verifikimi rezulton se trajtimi financiar i miratuar është në përputhje me kriteret ligjore dhe arsimore, ndaj kjo pikë nuk kërkon ndryshim, por shoqërohet me sqarim dhe dokumentacion përkatës bashkangjitur .

Në lidhje me shënimin e Prefektit, sqarojmë se në relacionin shoqërues te Vendimit nr 97 date 26.12.2025 janë reflektuar dhe plotësuar elementët përkatës sipas VKM nr. 328/2023, të ndryshuar, në mënyrë të veçantë: përcaktimi i grupit të diplomës për çdo pozicion pune si Drejtor,Pergjegjes,Specialist si dhe përshtatja e trajtimit financiar për punonjësit e shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit në përputhje me elementët e përcaktuar në VKM nr. 419/2024. Gjithsesi, për të garantuar qartësi dhe përputhshmëri të plotë në zbatim, këto elementë po pasqyrohen dhe sqarohen sërish në mënyrë të detajuar si me poshte vijon:

Kategoria	Klasa	Emertesa e pozicioneve te punes per cdo kategori	Grupi I diplomes
I	I-5	Sekretar I Pergjithshem	1
II	II-2	Drejtor Drejtorie	1
III	III-2	Pergjegjes Sektori/Kryeinspektor	1
III	III-3	Pergjegjes Sektori	1
IV	IV-3	Specialist/Inspektor	1,2,3
IV	IV-4	Specialist	1,2,3

Lidhja Nr. 1- Niveli I pagës për punonjësit e MZSH-së

Sipas VKM-së nr. 419, datë 26.6.2024 "Për miratimin e Vlerave për Secilin Element Përbërës të Pagës Bruto Mujore të Punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin"

Nr.	Emërtimi	Paga bazë për Gradë	Shtesa për Natyrë të vecantë punë	Shtesa për vjetërsi
1.	Asistent zjarrfikës	60, 000	7, 000	1%
2.	Zjarrfikës	65, 000	8, 000	1 %
3.	Kryezjarrfikës	70, 000	8, 000	1 %
4.	Inspektor zjarrfikës	75, 000	6, 000	1 %

-Në vijim të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore që kanë hyrë në fuqi ne perfundim te vitit 2026, konkretisht VKM nr. 776, datë 19.12.2025 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", është e domosdoshme që për pozicionet e punës të cilat trajtohen me pagë minimale, paga bazë mujore të përshtatet dhe të reflektojë nivelin e ri të pagës minimale prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Ky rishikim realizohet për të garantuar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe trajtimin e drejtë financiar të punonjësve.

Ndryshimet pasqyrohen në aneksin përkatës të vendimit.

Si rrjedhoje:

Në përfundim, projekt–vendimi i paraqitur:

-reflekton vërejtjet e Prefektit sipas pikave (a–f);

-sqaron pikën (g) pa ndryshuar trajtimin financiar;

-forcon qartësinë institucionale dhe ligjore të aktit;

-garanton zbatim korrekt të strukturës dhe pagave në nivel Bashkie.

Për këto arsye, kërkohet miratimi i projekt–vendimit dhe anekseve përkatëse.

Sekretar i Pergjithshem A.Rushitaj

KRYETARI I BASHKISE

EDUARD DURO

Adresa: Bashkia Devoll,Lagjia nr 1 Rr "24 Tetori" nr 9 Bilisht Tel.Fax: +355 811 2 2288 e-mail bashkiadevoll@gmail.com